



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 1921 / Prot.
13

Gramsh, më 03.06 . 2021

V E N D I M

Nr. 68 , datë 28.05 . 2021

PËR

**DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR VIJIMIN E PROÇEDURAVE TË HEQJES NGA
FONDI PYJOR/KULLOSOR PUBLIK PËR NDËRTIMIN E OPERIM TË HEC
“KOTORRI” NGA SHOQËRIA “ACHELO”SH.P.K**

Këshilli Bashkiak Gramsh në mbledhjen e tij të datës 28. 05.2021, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor mbështetur në KPA në Republikën e Shqipërisë: në Ligjin nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Ligjin nr. 107/2014 datë 3.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet”, të ligjit nr.9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullor” i ndryshuar, Ligjin nr. IO304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, në V.K.M-në në nr.433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive”, në V.K.M-në nr.591, datë 09.10.2018 “Për disa ndryshime në Vendimin nr.1353, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kriterëve e të proçedurave e të zvogëlimit të sipërfaqes e të vellimit të fondit pyjor” të ndryshuar (Pika 2, gërma b), në V.K.M-në nr.592, datë 09.10.2018 “Për disa ndryshime në Vendimin nr.1374, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe të proçedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”, të ndryshuar (Pika 2, gërma b), si dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nr.01, datë 08.06.2016 “Për rregullat, proçedurat e kërkimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, Këshilli Bashkiak.

V E N D O S I :

1. Miratimin për vijimin e proçedurave të heqjes nga fondi pyjor/kullor publik për ndërtimin e godinës së Hec Kotorri nga shoqëria “ACHELO” sh.p.k të sipërfaqjes pyjore prej 0.2685 ha, në ngastrën nr.32 (zallishtë) të ekonomisë pyjorë Galigat – Stror, Bashkia Gramsh.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor si strukturë përgjegjëse për pyjet dhe kullotat pranë Bashkisë Gramsh.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Xhulia GJINI



Konceptoi: Xh.Gjini
Pranoi: G.Lena
Miratoi: G.Lena
Dosja nr: _____
Afati i ruajtjes:

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Greta LENA

